

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHTETERORE PER MBROJTJEN E TË DHENAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ŽAŠTU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE			
Nr. e Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Hr. Prot. Prot. No:	17/2015
Nr. i faqeve Broj stranica Nr. pages:	03	Data Datum Date:	05/03/2015
PRISHTINË/A			

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Rr.regj.11022/14

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË, me gjyqtaren Anita Nikçi-Morina dhe sekretarja juridike Sevdije Gashi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike KE DS me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton Nr. 3 si person juridik, dhe personi përgjegjës [REDACTED] KEDS, si person përgjegjës për shkak të kryerjes së kundërvajtjes sipas dispozitave të nenit 14 para 1. Nënparagrafi 1 pika 3 të Ligjit për Mbrojtjes e të Dhënave Personale, në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 10.02.2015 mori këtë

A K T V E N D I M

Personi juridik, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike KEDS, me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton Nr.

Personi përgjegjës [REDACTED], i gjendjes së mesme ekonomike.

është përgjegjës

Sepse me datë 04.10.2013, gjatë inspektimit sipas detyrës zyrtare, personat zyrtarë të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se KEDS si person juridik nuk është duke zbatuar dispozitat e nenit 14 para 1 nënparag. 1 pika 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sepse me datë 04.10.2013 Personi përgjegjës [REDACTED], me veprimin e tij ka shkelur dispozitat e nenit 14 para 1 nënparag. 1 pika 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Andaj, Gjykata shpall të pandehurit përgjegjës dhe në pajtim me dispozitat e të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqipton këtë sanksion:

DËNIM

- Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike KE DS dënohet me gjobë në shumën prej 8.000 € (tetëmijë njëmijë)
- Personi përgjegjës në "KE DS" z. [REDACTED], dënohet me gjobë në shumën prej 1.000 € (njëmijë euro €) të cilën gjobë të pandehurit janë të obliguar ta paguajnë në një afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktvendim merrë formën e tij të prerë, në xhirollgarinë rrjedhëse të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 1000430070000518.

Nëse gjoba e shqiptuar nuk paguhet në afatin dhe xhirollgarinë e dhënë, gjoba e shqiptuar ndaj **personit juridik do të ekzekutohet me dhunë**, ndërsa personit përgjegjës e njëjtë do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditëve duke llogaritur 20 (njëzet euro €) për një ditë burgimi.

Shpenzimet të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të pashallit gjyqësorë të pandehurit janë të obliguar që të paguajnë shumën prej nga 5 € në afat dhe xhirollogari të nejtë me gjobën.

A R S Y E T I M

Agjencionii për Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraqiti kërkesën më datë 19 shkurt 2014 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurve 1) Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike KE DS me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton Nr. 3 si person juridik, dhe 2) personi përgjegjës [REDACTED] KEDS, si përsone përgjegjës për shkak të kryerjes së kundërvajtjes sipas dispozitave të nenit 14 para 1. Nënparagrafi 1 pika 3 të Ligjit për Mbrojtjes e të Dhënave Personale, i cili përcakton:

“Neni 14: Sigurimi i përpunimit të të dhënave 1. Sigurimi i të dhënave personale përfishinë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për mbrojtjen e tyre dhe parandalimin e çfarëdo shkatërrimi të paqellimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, zbulimin, ndryshimin, çasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre si: 1.1. duke i mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet aplikative (softuerët), përfshirë edhe kontrollin e qasjes; 1.2. duke i mbrojtur programet aplikative (softuerë) që përdoren për përpunimin e të dhënave; 1.3. duke parandaluar çfarëdo qasje të paautorizuar në ose leximin e të dhënave personal gjatë ruajtjes dhe transmetimit të tyre, përfshirë transmetimin nëpërmjet mijeteve të telekomunikimit dhe rrjeteve”.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dhënat personale janë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

Agjencia në kërkesën e saj pretendon se të pandeurit nuk kanë marrë masa preventive për parandalimin e qasjes së pautorizuar në leximin e të dhënave personale pasi saturat e energjisë elektrike të cilat përbajnë të dhënat personale kanë dërguar (shpërndarë) konsumatorëve pa i mbyllur në zarfa, duke i lënë saturat kudo në hapësirat e banimit, me çka iu është mundësuar paleve të treta qasje a pautorizuar në saturat e energjisë elektrike, veprim ky i cili bie ndesh me kërkesat e dispozitive të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për ruajtjen e të dhënave personale. Agjencia duke u bazuar në dispozitat e nenit 29, para. 2.1 dhe nenit 49 para. 1 pikë 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmes shkresës së saj të datës 25 mars 2013 i ka sugjeruar KEK-ut që brenda afatit 60 ditësh që të ndërmerr masa të nevojshme teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve duke bërë mbylljen në zarfë të të dhënave për secilin konsumator, dhe që për masat e ndërmarra të njoftoj Agjencinë brenda afatit prej 15 ditësh (Provë).

Shkresë-rekomandimi i Agjncisë i datës 25.03.2013
Fotografi nga vendi i ngjarjes

Agjencia përmes shkresës së saj me Nr. 59/2013 të datës 11.07.2013 i ka përkujtuar KEK-distribuimit në Prishtinë, tanë pas privatizimit me emrin e ri KEDS që kjo korporatë nuk e ka informuar me shkrim Agjencinë për masat e ndërmarra sipas rekomandimit të lartëpërçpermendur gjicë më datën 10.06.2013. Agjencia ka bashkangjitur (Provë).
Shkresë-rekomandimi i Agjncisë i datës të datës 11.07.2013.

Në anën tjetër KEDS duke iu përgjigjur pretendimeve të ngritura nga Agjencia në shkresën Nr. 59/2013 të datës 11.07.2013, përmes shkresës së vet me numër Nr. 17 të datës 19.07.2013 njofton Agjencinë se çështjes juridike i mungon legjitimiteti me arsyetimin se KEDS është subjekt i ri ligjor dhe se Rekomandimi i Agjncisë i datës 25.03.2013 i fuqizuar me vendimin e datës 16.04.2013 nuk i është përcjellë me marrëveshjen e transferit të datës 8 maj 2013. Provë **Shkresë-rekomandimi i Agjncisë i datës 19.07.2014**

Andaj gjykata inicdoi procedurën me marrjen në pyetje të pandhurit, përfaqësuesin e KEDS-it [REDACTED], i cili mohoi kundërvajtjen e cila i vihet në barrë. I pandehuri theksoi se pretendimet e ngritura të Agjencionit janë të pabazuara dhe të paargumentuara dhe në kundërshtim me nenin 14 para. 1 pikë 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sepse kompania me asnjë veprim nuk ka cënuar të drejtën e privatësisë së konsumatorëve të saj. Gjykata procedoi me marrjen në pyetje të drejtitorit të KEDS-it [REDACTED], i cili në tërësi mohon pretendimet e ngritura dhe qëndron pranë deklaratës së dhënë të përfaqësuesit juridik të KEDS-it.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, Gjykata ftoi në cilësimë e dëshmitarit përfaqësuesin e Agjncisë për Mbrojtjen e të Dhënave z. Ruzhdi Jashari, (Mbikqyrës Kryesor Shtetëror në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave), i cili në deklaratën e tij dhëne pranë Gjykatës theksoi se mbetet pranë kërkesës së parashtruar se të pandhurit kanë kryer kundërvajtjen e referuar më lartë, duke sjellur edhe prova nga vendi i ngjarjes si CD me foto nga vendi i ngjarjes dhc matricale të tjera.

Gjykata çmon të arsyeshme të nënvisojoz se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në nenin 2 të dhënat personale i përkufizon si “çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror”. Për më tepër, mbrojtja e të dhënave personale rregullohet edhe me dispozita kushtetuese, ku në nenin 36 të Kushtetutës para. 4 përcaktohet se “Secili person gjëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigeimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj”.

Gjykata dëshiron të rikujtoj se në kuptim të Direktivës së BE-së nr. 95/46/EC për mbrojtjen e të dhënave personale informacioni në lidhje me individë që emërohen si “të dhëna personale” mblidhen dñe përdoren në shumë aspekte nga jeta e përditshme, si për shembull me rastin e hapjes së llogarive bankare, apo edhe të nenshkrimit të kontratës me kompani

publike, të cilat mund të përdoren për qëllimet dhe/ose mund të ndahen me palë të tjera në kushte të përcaktuara me ligj. Të dhënët personale mund të jetë çdo e dhënë që identifikon një individ, të tilla si një emër, një numër telefoni ose ose edhe të dhëna që paraqesin gjendjen ekonomike ose detyrimet fiannciare të individit. Në kuptim të kësaj Gjykata konsideron se është pikërisht qëllimi i nenit 14 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili sankzion se të dhënët personale duhet të bëhen në atë mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e tyre nga çfarëdo qasje e paautorizuar ose lexim i të dhënave personale gjatë rruajtjes së tyre, përshtfshirë këtu edhe shpërndarjen e tyre.

Gjykata ka bërë shiqimin e shkresave të lëndës, si CD dhe fotografi nga vendi i ngjarjes dhe ka analizuar provave të tjera të administruara gjatë procedurës dhe në masë të mjaftuar vërtetoi se të pandehurit kanë kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.

Me rastin e shqiptimi të dënimit, Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurve ia shqiptoi këtë lloj dënim, duke konsideruar se edhe me këtë do të arrihet efekti i sankzionimit dhe do të ndikoi që të pandehurit në të ardhmen do t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme kundërvajtëse.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi të pandehurit dhe parashtruesi i kërkesës mund të parashtronë ankesë Gjykatës së Apelit/ Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë në afat prej tetë (8) ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

GJYQTARJA

Anita Nikçi – Morina

